

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kz. Nr. 394/2007**  
**2 korrik 2009**  
**Prishtinë**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e formuar në përputhshmëri me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi Kompetencat), të përbërë nga:

- Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, Kryetar dhe gjyqtar raportues,
- Maria Giuliana Civinini, Gjyqtare e EULEX-it, anëtare e kolegjit,
- Salih Mekaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtar i kolegjit,
- Miftar Jasiqi, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtar i kolegjit dhe
- Fejzullah Hasani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtar i kolegjit;

Të ndihmuar nga Judit Eva Tatrai, Zyrtare Ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse, Robert Abercrombie, procesmbajtës i EULEX-it, Lekë Nimani, Vegim Rugova, Naser Syla dhe Mentor Osmani, përkthyes të EULEX-it;

Në prani të Prokurorëve Publik, Anette Milk Prokurore e EULEX-it, Besim Kelmendi Prokuror Publik, të pandehurit Nexhmedin Gashi dhe Hajrë Gashi, Avokatët Mbrojtës Naser Peci për Nexhmedin Gashin dhe Destan Rukiqi për Hajrë Gashin;

Në seancën e mbajtur më 30 qershor 2009, pas këshillimeve të kolegjit të përfunduara më 30 qershor dhe 2 korrik 2009;


Në rastin penal kundër:

Nexhmedin Gashit: me nofkën Nexh, shqiptar kosovar, i lindur më 24 mars 1971 në Vërboc, emri i babait Hajredin, mbiemri i vajzërisë së nënës Zahide Shabani, me vendbanim në Drenas, Kosovë, i martuar, me gjendje ekonomike mesatare, ka mbaruar shkollën e mesme, zdrukthëtar, nuk dihet për dënime të mëhershme, në paraburgim për këto akuza prej 4 korrikut 2005, momentalisht në paraburgim në burgun e Dubravës; dhe

Hajrë Gashin: shqiptar kosovar, i lindur më 10 janar 1966 në Vërboc, Kosovë, emri i babait Adem, mbiemri i vajzërisë së nënës Hata Kukaj, me vendbanim në Drenas blloku 2, hyrja 2, katiti 4-të, banesa nr. 10 dhe në Vushtrri, Rr. Arsim Musaqi 94 dhe në fshatin Vërboc, i martuar, me gjendje ekonomike mesatare, ka mbaruar shkollën e mesme, teknik i kimisë dhe fizikës, nuk dihet për dënime të mëhershme, në paraburgim për këto akuza prej 1 korrikut 2005, momentalisht në paraburgim në burgun e Dubravës;

Duke vendosur mbi ankesën e Prokurorit Publik të paraqitur më 9 korrik 2007, në dëm të të pandehurve Nexhmedin Gashit dhe Hajrë Gashit;

Aktgjykimi  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 394/2007  
Nexhmedin Gashi & Hajrë Gashi



Duke vendosur mbi ankesën e Avokatit Mbrojtës Destan Rukiqit të paraqitur më 12 korrik 2007 ne dobi të të pandehurit Hajrë Gashit, dhe gjithashtu mbi ankesën e Avokatit Mbrojtës Naser Pecit të paraqitur më 16 korrik 2007 në dobi të të pandehurit Nexhmedin Gashit;

Të gjitha të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 740/2005, të datës 27 prill 2007;

Pas shqyrtimit të të dhënave të gjykatës, dëgjimit të argumenteve të Prokurorit Publik dhe ato të Avokatëve Mbrojtës, dhe pas analizimit të Ligjeve relevante;

Në pajtim me nenin 426, paragrafin (1) të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

### AKTYGJYKIM

Ankesa e Prokurorit Publik e paraqitur më 9 korrik 2007 në dëm të të pandehurve Nexhmedin Gashit dhe Hajrë Gashit, **PRANOHET PJESËRISHT**;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Destan Rukiqit e paraqitur më 12 korrik 2007 ne dobi të të pandehurit Hajrë Gashit, **REFUZOHET** si e **PABAZUAR**;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Naser Pecit e paraqitur më 16 korrik 2007 në dobi të të pandehurit Nexhmedin Gashit, **PRANOHET PJESËRISHT**;

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 740/2005, i datës 27 prill 2007, **NDRYSHOHET**:

1) sa i përket kualifikimit të veprave penale për të cilat Nexhmedin Gashi është shpallur fajtor:


a) në PIKËN 1 të aktgjykimit, Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, në kundërshtim me nenin 245, paragrafin (2) të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së);

b) në PIKËN 2 të aktgjykimit, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafin (3) të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së);

c) në PIKËN 3 nënpika (vii) e aktgjykimit, Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, në kundërshtim me nenin 245, paragrafin (2) të KP të RSFJ-së;

2) sa i përket kualifikimit të veprave penale për të cilat Hajrë Gashi është shpallur fajtor në PIKËN 2 të aktgjykimit, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafin (3) të KPK-së;

Aktgjykimi  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 394/2007  
Nexhmedin Gashi & Hajrë Gashi



3) Nexhmedin Gashi nuk është fajtor dhe lirohet nga gjashtë (6) pikat e Prodhimit dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, sipas nenit 245, paragrafit (2) të KP të RSFJ-së siç është përshkruar në PIKËN 3 nën-pikat (i) – (vii) të aktgjykimit;

4) Nexhmedin Gashi shpallet fajtor për një (1) pikë të Krimin të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafin (3) të KPK-së, siç është përshkruar në PIKAT 1, 2 dhe 3 (vii) të aktgjykimit;

5) Hajrë Gashi shpallet fajtor për Krim të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafin (2) të KPK-së, siç është përshkruar në PIKËN 2 të aktgjykimit me një dallim që ai ka qenë anëtar e jo udhëheqës i grupit të organizuar kriminal;

Pjesa e mbetur e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 740/2005, i datës 27 prill 2007, **VËRTETOHET**;

I pandehuri duhet ti paguaj shpenzimet e procedurës penale.

## **Arsyetimi**

### **1. Procedura:**

- Ankesat e dorëzuara me kohë të Prokurorit Publik, të avokatit mbrojtës në emër të Hajrë Gashit dhe të avokatit mbrojtës në emër të Nexhmedin Gashit janë të pranueshme.

### **2. Kualifikimi i krimeve:**


- Kolegji i Gjykatës Supreme përkujton që pikat/kualifikimi i cili në mënyrë ligjore përshkruan krimet që pohohen të jenë kryer nga i pandehuri duhet të jenë të sakta dhe të qarta sa i përket kohës, elementeve materiale të krimin dhe rrethanave në të cilat janë kryer krimet. Kjo qartësi dhe saktësi përshkruhet në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të kuptoj dhe zbuloj të vërtetën lidhur me faktet të cilat i mbështesin pohimet dhe që i pandehuri të jetë në gjendje ta mbrojë rastin e tij në mënyrë të duhur. Pika 3, nën-pikat i)-iv) (gjashtë nën-pikat), prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve nuk përputhen me kriterin minimal të qartësisë dhe saktësisë, dhe Gjykata Supreme për shkak të paqartësisë dhe dyshimit të krijuar duhet ta lirojë të pandehurin Nexhmedin Gashin nga këto pika (shiko dispozitivin).

- Gjykata Supreme për hir të qartësisë korrigjon pikat tjera duke e precizuar kualifikimin si në vijim:

*PIKA 1: Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, në kundërshtim me nenin 245 paragrafin (2) të Kodit Penal të RSFJ-së, pasi që kodi penal që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer krimi është më i favorshëm për të akuzuarin krahasuar me nenin 229 paragrafin (3) të KPK-së sepse parasheh minimumin më të ulët të dënimit;*

*PIKA 2: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, sipas nenit 229, paragrafin (3) të*

Aktgjykimi  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 394/2007  
Nexhmedin Gashi & Hajrë Gashi



*KPK-së, sepse vepra penale është kryer në qershor 2004, pas hyrjes në fuqi të KPK-së;*

*PIKA 3 nënpika (vii): Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, në kundërshtim me nenin 245 paragrafi (2) i KP të RSFJ-së, pasi që kodi penal që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer krimi është më i favorshëm për të akuzuarin krahasuar me nenin 229 paragrafin (3) të KPK-së sepse parasheh minimumin më të ulët të dënimit.*


- Sa i përket krimit të ndarë të Krimit të Organizuar (neni 274 KPK-së) lidhur me krimet në Pikat 1, 2, 3 (vii), Gjykata Supreme precizon që i pandehuri Nexhmedin Gashi akuzohet si organizator (neni 274 paragrafi (3) i KPK-së), dhe Hajrë Gashi si anëtar aktiv i organizatës kriminale (neni 274 paragrafi (2) i KPK-së). Gjykata Supreme zotohet që kushtet e nenit 274 (7) të KPK-së janë përmbushur sipas dispozitave të ligjit. Në të vërtetë në këtë rast është e dukshme që gjithashtu duke marrë parasysh shumën e madhe të të hollave dhe drogës së përfshirë, importin ndërkombëtar, eksportin dhe transportin e heroinës dhe kapacitetin organizativ të grupit kriminal, udhëheqja e domosdoshme, koordinimi dhe menaxhimi i aktiviteteve ndërkombëtare, janë arsye më shumë se të mjaftueshme që të përcaktohet *in casu* – pasi që dëshmitë në dosje dhe dëshmitë e marra përmes dëshmitarëve gjatë gjykimit, tregojnë qartë – që i pandehuri Nexhmedin Gashi ka udhëhequr këtë grup në mënyrë që të përfitoj profit enorm ilegal përmes trafikimit të drogës kryesisht nga Kosova për në Itali. Hajrë Gashi, në mes tjerash, duhet të konsiderohet si një anëtar shumë i rëndësishëm dhe si dora e djathtë e Nexhmedin Gashit në veçanti lidhur me faktet e përshkruara në Pikën 2.

- Këto trafikime kriminale të drogës (Pikat 1, 2, 3vii) duhet të konsiderohen në kundërshtim me aktgjykimin e shkallës së parë, si “krime serioze” sepse ato janë të dënueshme me burgim “së paku katër vjet” (neni 274 (7) 3) i KPK-së). Në të vërtetë burgimi prej 4 viteve është në kuadër të burgimit të përcaktuar me nenin 245 (2) të KP të RSFJ-së dhe nenit 229 (3) të KPK-së. Përfundimisht, Gjykata Supreme ka vërejtur që përveç organizatorit dhe punëtorëve të tij gjithashtu edhe një numër i korrierëve të drogës kanë qenë të përfshirë, disa prej tyre janë dënuar lidhur me trafikimin e lartpërmendur të drogës nga Gjykatat Penale të huaja (Slloveni, Gjermani).

### **3. Faktet:**

- Gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar saktësisht dhe në mënyrë ligjore në bazë të deklaratave të dëshmitarëve, në bazë të gjetjeve të policëve dhe në bazë të masave të fshehta të ekzekutuara në mënyrë ligjore nga policët kompetent, që i pandehuri Nexhmedin Gashi ka organizuar dhe mbikëqyrur – gjatë gjithë periudhës siç është përshkruar në Pikat 1, 2, 3 vii – disa trafikime të drogave (heroin) nga baza e tij në Kosovë duke përdorur stafin kriminal, korrier të huaj, vetura të huaja të cilat i ka gjetur në Gjermani. Është e qartë, siç është dëshmuar me shkresat e lëndës dhe procedurat gjyqësore në shkallën e parë, duke vepruar kështu Nexhmedin Gashi ka mundur të llogaris në një grup të besueshëm, të disiplinuar dhe të strukturuar mirë të shoqëruesve në krim të cilët kanë përfituar ilegalisht duke bërë trafikime të rrezikshme të drogës (totali i së paku 40,5 kg të heroinës së rrezikshme), një shumë të madhe të hollave për një periudhë shumë të shkurtë kohore. Kjo veprimtari shumë fitimprurëse ilegale ishte

Aktgjykimi  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 394/2007  
Nexhmedin Gashi & Hajrë Gashi



qëllimi i vetëm i kësaj organizate kriminale të udhëhequr nga Nexhmedin Gashi (Pikat 1, 2, 3vii).

- Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar në mënyrë të njëjtë të saktë dhe ligjore përfshirjen aktive të Hajrë Gashit në trafikim të drogës (Pika 2) dhe ka specifikuar rolin e tij, krahas rolit udhëheqës të Nexhmedin Gashit, si anëtar aktiv i organizatës kriminale. Edhe pse, Hajrë Gashi nuk mund të konsiderohet që ka pasur rolin e paraparë me nenin 274 (3) të KPK-së.

- Prandaj, Gjykata Supreme, duke përcaktuar që Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar faktet materiale në mënyrë të duhur, i referohet aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si përgjigje në bazat faktike ( të pabazuara) të ankesës së të dy të pandehurve lidhur me Pikat e përmendura më lartë, dhe ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë vetëm lidhur me aplikimin e ligjit sipas nenit 426 (1) të KPPK-së siç është e specifikuar në dispozitiv.

#### **4. Dënimi:**

- Edhe pse Gjykata Supreme ka shpallur të pandehurit fajtor edhe për Pikën e “Krimin të Organizuar” (organizator/anëtar aktiv) dënimi i tyre nuk ka mundur të rritet për shkak se nuk ka pasur ankesë nga Prokurori për një dënim të tillë. Prandaj, është vendosur sikur në dispozitiv; vërtetohet dënimi.

### **Gjykata Supreme e Kosovës**

**Ap.-Kz. Nr. 394/2007**

**2 korrik 2009**

**Prishtinë**

#### **Anëtarët e kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
**Maria Giuliana Civinini**  
Gjyqtare e EULEX-it

\_\_\_\_\_  
**Salih Mekaj**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Fejzullah Hasani**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Miftar Jasiqi**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

#### **Kryetar i Kolegjit:**

#### **Procesmbajtëse:**

\_\_\_\_\_  
**Guy Van Craen**  
Gjyqtar i EULEX-it

\_\_\_\_\_  
**Judit Eva Tatrai**  
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Aktgjykimi  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 394/2007  
Nexhmedin Gashi & Hajrë Gashi

